

19 mars 2015, Prizren

LETËR PUBLIKE

Strategjia komunale për informim është hartuar me qasje përjashtuese

Komuna e Prizrenit ka iniciuar hartimin e Strategjisë Komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje qytetare. Në versionin para-final, të shpërndarë nga Zyra për Informim e Komunës së Prizrenit, në pjesën ku përshkruhet metodologjia në faqen 15 thuhet se “strategjia është hartuar me një pjesëmarrje të gjerë, duke përfshirë përfaqësues të organeve komunale relevante, organizatave të shoqërisë civile dhe të medieve”.

Ndërsa në faqen 14 sqarohet se “fillimisht është organizuar një punëtori me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, ku janë identifikuar fushat problemore që duhen adresuar me strategji. Gjithashtu, është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e problemeve sipas fushave problemore”. Tutje shkruan se “për hartimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për komunën e Prizrenit është formuar një grup i punës, i përbërë nga përfaqësues të komunës, nga OSHC-të, OJQ-të dhe ekspertë të fushave përkatëse, si dhe organeve gjegjëse komunale, sic është ZIP, zyra ligjore dhe zyra për integritet evropian”. Përveç kësaj, thuhet se janë “konsultuar edhe përfaqësues të zyrave për informim nga komunat tjera...”.

Po ashtu theksohet se “tryezat dhe punëtoritë gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit për përfshirjen e sa më shumë palëve nga qeverisja lokale dhe komuniteti i OJQ-ve” dhe se kjo qasje “ofron garanci që strategjia do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë”. Në këtë draft potencohet se “metodologjia e përdorur në procesin e hartimit të strategjisë dhe të planit të veprimit është përmes planifikimit me pjesëmarrje të gjerë, gjegjësisht përmes metodologjisë së kornizës logjike dhe veglave të saja të planifikimit”.

Forumi Transparenca përmes kësaj letre publike dëshiron që ta njoftojë opinionin se pjesa dërrmuese e anëtarëve të saj, e veçanërisht komuniteti i gazetarëve nuk janë përfshirë fare në procesin e konsultimeve për hartimin e kësaj strategjie.

Për këtë shkak Forumi Transparenca konsideron se Strategjia komunale për informim, komunikim dhe pjesëmarrje qytetare e Komunës së Prizrenit është hartuar me një qasje përjashtuese, sidomos ndaj komunitetit të gazetarëve, por edhe aktivistëve të shoqërisë civile që kanë përvojë disavjeçare në monitorimin e punës së organeve komunale, si dhe grupeve të qytetarëve, të cilat në këtë rast janë palë tejet të rëndësishme të interesit sa i përket informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes qytetare.

Forumi Transparenca dëshiron të sjellë në vëmendje se vendimi i kryetarit të komunës për lejimin e hartimit të strategjisë është marrë më 3 shkurt, derisa drafti i parë është prezantuar para gazetarëve dhe monitoruesve nga shoqëria civile vetëm pas tre javësh, më 25 shkurt, dhe atë në një konferencë për shtyp. Pas vërejtjeve të paraqitura, kanë pasuar ftesat për OJQ-të për një punëtori e një tryezë, por jo edhe për gazetarët.

Forumi Transparenca vlerëson se gazetarët e Prizrenit nuk e kanë merituar një injorim të tillë në hartimin e këtij dokumenti strategjik dhe se është dashur të jenë të përfshirë nga fillimi në procesin e hartimit të këtij dokumenti strategjik, njëjtë sikurse edhe aktivistët e shoqërisë civile që kanë përvojë shumëvjeçare në monitorimin e punës së organeve komunale.

Me këtë rast Forumi Transparenca shpreh dyshimet e bazuara të anëtarëve të saj se hartimi i strategjisë nuk është realizuar me pjesëmarrje të gjerë dhe se si i tillë është ndërtuar bazuar në vlerësimet e ngushta, pa i përfshirë nevojat e të gjitha palëve të interesit.

Forumi Transparenca është themeluar në mars të vitit 2014, si përpjekje e koordinuar e akterëve të shoqërisë civile dhe mediave në Prizren, të cilët kanë për synim rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë lokale të Prizrenit. Ky trup joformal përbëhet nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit, të cilët janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike.

Në emër të Forumit Transparenca,
Elmedina Baxhaku, EC Ma Ndryshe (Sekretariati i Forumit Transparenca)
Saraçët 5, 20000/Prizren
elmedina.baxhaku@ecmandryshe.org
029 222 771